



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:005324

Datë: 14.09.2021

Numri i dokumentit: 02170243

C.nr.09/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Besnik Feka, në çështjen juridike të paditësit M. I. nga fsh. S.i P.Vushtrri, të cilin e përfaqëson me autorizim Av. Fatmire Braha nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë- Drejtoria per Arsim, lidhur me pagesen e ushqimit ne pune , vlera e kontestit **668€**, gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, ne prezence te përfaqësuesve te palëve, jashtë seance, me datën 14.09.2021, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit M. I. ashtu që:

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Vushtrrisë, që paditësit M. I.ne emër te **135** ditëve te pranisë ne pune per periudhën kohore **13.01.2018** e gjer me **03.09.2018**, t'ia paguaj shumën totale prej **270€** (per çdo dite te pranisë ne pune shumen nga **2 euro**), me kamate ligjore prej **8% vjetore**, duke filluar nga data e ushtrimit te padisë **13.01.2021**, e gjer ne përmbushjen perfundimtare te detyrimit.

III. Secila pale i barte shpenzimet e saj te procedurës.

IV. REFUZOHET pjesa tjetër e kerkesëpadisë së paditësit për kompenzimin e shujtave ne emër te **199** ditëve te pranisë ne pune per periudhën kohore **18.04.2017** e gjer me **13.01.2018** ne shume totale prej **398 euro (per secilën dite pune shumen nga 2 euro)**, **PER SHKAK TE PARASHKRIMIT.**

A r s y e t i m

Paditësi M. I.nga fsh. S. i P./Vushtrri, përmes të autorizuarit të tij Av. Fatmire Braha nga Vushtrria, pranë kësaj gjykate me datën 13.01.2021, kaparaqitur padi për pagesen e ne emër te 334 diteve te pranisë ne pune per periudhën kohore prej 18.04.2017 e gjer me 03.09.2018. shumen totale prej 668 euro, me kamate ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata, ka caktuar dhe mbajtur seancen gjyqësore, në të cilën seancë mori pjesë përfaqësuesi i paditëses me autorizim Av. Fatmire Braha nga Vushtrria dhe përfaqësuesi i të paditues I. G.

Përfaqësuesi me autorizim i paditësit Av, Fatmire Braha në seancën e shqyrtimit pergaditore të mbajtur me datë 08.09.2021, e po ashtu edhe në shqyrtim kryesor të mbajtur me datën e njejtë, ka deklaruar qe mbetem ne teresi prane padise dhe kerkesepadise, ashtu qe, ne emer te kompensimit te shujtave per 334 dite te pranise ne pune per periudhen kohore prej 18.04.2017 e gjer me 03.09.2018, , paditesit t'ia paguaje shumen totale prej 668 euro, me kamate ligjore dhe shpenzimet e procedures.

Perfaqesuesi I te paditues I. G. nuk ka ushtruar pergjigje ne padi, mirepo ne seancen pergatitore dhe ate te shqyrtimit kryesor deklaroi: E kundërshtojme pjesërisht kerkesepadine e paditesit ngase per periudhen kohore nga 18.04.2017 e gjer me 13.01.2018, per ditet e pranise ne pune prej 199 diteve, konsiderojme se kerkesa eshte parashkruar konform nenit 87 te Ligjit te Punes, sepse kane kaluar me teper se 3 vite, ndersa pjesen tjeter te kerkeses per 135 dite te punes nuk e kundërshtojme, keshtu qe, gjykates per periudhen qe e pohojme padine ia dorezojme vertetimin e te paditues per ditet e pranise ne pune nga e paditura.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor publik të datës 08.09.2021, bëri leximin dhe administrimin e provave vertetimin e pervojës së punës së paditesit të leshuar nga e paditura e dates 05.05.2021 per periudhen kohore 18.04.2017 e gjer me 03.09.2018, vertetimin e leshuar nga e paditura dt: 07.09.2021 per ditet e pranise ne pune per periudhen kohore 13.01.2018 e gjer me 03.09.2018, dhe pas vleresimit te te gjitha provave gjykata konstatoi kete gjendje:

Nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte I punësuar punësuar te e paditura dhe atë në Shkollën e Mesme “E. Ç.” ne Vushtrri.

Nga vertetimi I leshuar nga e paditura dt: 05.01.2021, vertetohet se paditesi per periduehn kohore 18.04.2017 e gjer me 03.09.2021, ka dite te pranise ne pune te e paditura gjithsej 334 dite, ndersa nga vertetimi I leshuar poashtu nga e paditura dt: 07.09.2021, vertetohet se paditesi per periudhen kohore 13.01.2021 e gjer me 03.09.2021 ka gjithsej dite te pranise ne pune gjithsej 135 dite pune.

Gjykata lidhur me vendosjen sipas pikes I dhe II te dispozitivit gjeti se kerkesepadia e paditesit per periudhen kohore 13.01.2018 e gjer me 03.09.2018 per 135 dite te pranise ne pune eshte e bazuar, pasiqe, e njejta edhe nuk u kundërshtua nga perfaqesuesi I te paditues dhe gezon mbeshtetje ligjore ne nenin 35 par.7 te Kontrates Kolektive te Arsimit Parauniversitar e cila ka hyre ne fuqi me dt: 18.04.2017, ashtu qe, paditesit per kete periudhe kohore I njihet e drejta ne kompensim te shujtave ditore sipas pikes II te dispozitivit, krejt kjo e mbeshtetur edhe ne nenin 8 dhe 245 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 ku percaktohet “ **Kreditori në marrëveshjet detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkoj**

përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”.

Sa I perket pikes **IV** te dispozitivit, refuzimit te kerkesepadise se paditesit per 199 dite te pranise ne pune per periudhen kohore 18.04.2017 e gjer me 13.01.2018, ne shume totale prej 398 euro, kjo kerkese eshte e parashkruar konform nenit 87 te Ligjit te Pune snr. 03/L-212, ku percaktohet “***Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës***”, dhe meqenese paditesi padine e ka ushtruar me dt: 13.01.2021, atehere te gjitha kerkesat ne te holla te arritura deri me dt: 13.01.2018, jane te parashkruara, dhe gjykata pas konstatimit te ketij fakti gjeti se kjo pjese e kerkesepadise per shkak te arritjes se parashkrimit duhet te refuzohet.

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedures, gjeti se duhet vendosur ne baze te nenit 452 par.2 te LPK-se, ashtu qe, vleresoi qe secila pale duhet ti barte shpenzimet e saj te procedures, duke marre per baze edhe lartesine e aprovuar te kerkesepadise.

Gjykata, me rastin e aplikimit te kamates ligjore, iu referua nenit 382, par.1 dhe 2 te Ligjit per Marredheniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, ne te cilen parashihet “ ***Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën***, ndersa ne par.2 te te njejtit nen parashihet “***Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë***”, ndersa sa I perket rrjedhjes se kamatevoneses, iu referua mendimit juridik per kamaten nr. 265/20, dt: 01.12.2020, pikes XVII te ketij mendimi, ku percaktohet se per kerkesat nga pagat dhe dheniet tjera materiale e kamatevoneses rrjedh nga data e arritjes se kerkeses per pagese, ashtu qe, dhe gjykata vlereson se debitori ka rene ne vonese ne permbushje ndaj kreditorit qe nga data e ushtrimit te padise e tutje.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 par.1 te LPK-se, vendosi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 09/21 datë: 14.09.2021**

**GJYKATESI
Besnik Feka**

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 7 ditësh nga dita vijuese pas ditës së marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.